



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

ETIKOS

Etika e raportimit
në media online

2025



Autor dhe botues: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK)

www.presscouncil-ks.org

Ky raport është mbështetur nga projekti i UNESCO-s “Building Trust in Media in South East Europe: Support to Journalism as a Public Good”. Gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Janar, 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
METODOLOGJIA	3
PRETENDIMET E SHKELJEVE ETIKE NË MEDIAT ONLINE	4
ANKESAT E MIRATUARA DHE TË REFUZUARA	6
PËRFUNDIME	11
ANEKS 1 – KODI I MEDIAVE TË SHKRUARA TË KOSOVËS	12
ANEKS 2 – ANKESAT E PRANUARA DHE TË TRAJTUARA GJATË VITIT 2025	17

Hyrje

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. KMSHK është themeluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë në shtator të vitit 2005, ndërsa Zyra e KMSHK-së akti vitetin e rregullt e ka filluar në dhjetor të vitit 2005.

Fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht, me kohë dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë janë baza mbi të cilën vepron KMSHK. Qëllimi i KMSHK-së është ta mbrojë qytetarin nga shkrimet e pavërteta, si dhe ta mbrojë gazetarin nga ankesat e pambështetura.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës aktualisht ka 49 anëtarë. Kuvendi i anëtarëve përbëhet nga përfaqësuesit e mediave online dhe agjencive të lajmeve.

Veprimtaria e KMSHK-së shtrihet në fuqizimin e respektimit të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, edukimin e brezave të rinj të gazetarëve dhe studentëve të gazetarisë lidhur me parimet e Kodit të Mediave të Shkruara, me qëllim të sigurimit të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar drejt dhe me kohë.

Shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës kanë vazhduar të paraqiten kundër mediave anëtare dhe joanëtare, ndërsa Këshilli ka vazhduar të shtyjë përpara misionin e vet të ruajtjes së profesionalizmit medial në Kosovë.

Gjatë vitit 2025, KMSHK-ja ka pranuar **gjithsej 150 ankesa**.

Në mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2025, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) **ka miratuar plotësisht 38 ankesa (rreth 25.3 për qind), ka miratuar pjesërisht 27 ankesa (18 për qind), ka hedhur poshtë 57 ankesa (38 për qind), 19 prej tyre (12.6 për qind) janë shpallur të patrajtueshme, ndërsa 9 ankesa (rreth 6 për qind) të paafatshme.**

Sikurse edhe viteve paraprake, ankesat kryesisht kanë pasur të bëjnë me kapitullin që trajton raportimin e së vërtetës dhe lajmet e rreme, ndërsa ka pasur edhe ankesa lidhur me të drejtën për t'u përgjigjur, si dhe privatësinë dhe mbrojtjen e burimeve.

Metodologjia

Ky raport është realizuar duke u mbështetur në të dhënat që Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) i ka marrë dhe i ka procesuar gjatë vitit 2025.

Duke marrë parasysh se ankesat që i pranon Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës zakonisht përm- bajnë më shumë se një pretendim të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, raporti është përpiluar asisoj duke kategorizuar:


- Pretendimet e shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës – ku janë përfshirë të gjitha pretendimet që KMShK-ja i ka pranuar gjatë vitit 2025 lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe

- Vendimet e marra nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës lidhur me pretendimet në fjalë. Këtu hyjnë shkeljet e miratuara dhe ato të refuzuara. Arsyeja për një metodologji të këtillë është që mediave tona anëtare dhe opinionit të gjerë t'ua ofrojmë një pasqyrë të asaj që ata hasin në media online çdo ditë, pra të atij raportimi që opinionit publik rëndom e konsideron si joprofesional, si shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Pra, fokusi në pretendimet e shkeljeve është që të ofrohet një pasqyrë mbi perceptimin e opinionit rreth cilësisë dhe profesionalizmit të raportimit medial në Kosovë.

Pretendimet e shkeljeve etike në mediat online

Gjatë vitit 2025, KMShk ka pranuar **gjithsej 150 ankesa**, ose 26 më shumë se në vitin 2024.




Grafika 1. Numri i përgjithshëm i ankesave gjatë vitit 2025 krahasuar më 2024

Në mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2025, KMShk ka miratuar plotësisht 38 ankesa, ka miratuar pjesërisht 27 ankesa, ka hedhur poshtë 57 ankesa, 19 prej tyre janë shpallur të patrajtueshme, ndërsa 9 ankesa të paafatshme.

Në këtë kapitull janë paraqitur të gjitha shkeljet e pretenduara të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara i ka pranuar gjatë vitit 2025. Siç është cekur edhe në metodologjinë më lart, kjo pjesë shtjellon shkeljet e pretenduara, pra ankesat që KMShk i ka pranuar nga opinioni publik lidhur me raportimin profesional, raportimin joetik, me kapitujt, paragrafët dhe pikat e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Mediave të Shkruara i ka procesuar 150 pretendime të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Më poshtë, gjeni **ankesat** sipas muajve.



Grafika 2. Pretendimet e shkeljeve sipas muajve, 2025

Grafika tregon se trendi i dërgimit të ankesave në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës kryesisht është konstant. Përfundim këtu bëjnë muajt maj, qershor, korrik dhe tetor, kur ka pasur më së shumti pretendime të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, derisa në muajt mars, prill dhe shtator janë pranuar nga gjashtë, përkatësisht shtatë ankesa.

Në vijim është paraqitur numri i përgjithshëm i **vendimeve për shkelje** të kodit të etikës:

Numri i përgjithshëm i vendimeve gjatë vitit 2025



Grafika 3. Numri i përgjithshëm i vendimeve për shkelje të kodit të etikës

Në Këshillin e Mediave të Shkruara vazhdojnë të vijnë ankesat në lidhje me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, ndërsa problem më të madh në raportim – gjithmonë sipas lexuesve dhe atyre që preken drejtpërdrejt nga raportimi – vazhdon të jetë raportimi i së vërtetës, i cili është i rregulluar brenda Kapitullit II të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Pika 1 e këtij kapitulli thotë:

“Gjatë punës së tyre, gazetarët dhe redaktorët do të sigurojnë respekt për të vërtetën faktike dhe për të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën”.

Po ashtu, diçka që tradicionalisht ka qenë lëndë e ankesave drejtuar Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, është demanti apo e drejta për t’u përgjigjur dhe Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës parasheh që:

“Është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve e agjensive të lajmeve që të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë”.

Kështu, Raportimi i së vërtetës dhe E drejta për t’u përgjigjur, gjegjësisht Kapitulli II dhe Kapitulli IV i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës vazhdojnë të jenë dy aspektet kryesore të cilat trajtohen nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe të cilat vazhdojnë të përbëjnë sfida në raportimin e mediave online në Kosovë.

Ankesat e miratuara dhe të refuzuara

Në këtë kapitull shtjellohen ankesat - pra pretendimet e shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës - të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës i ka miratuar si të bazuara apo i ka hedhur poshtë si të pabazuara, të patrajtueshme dhe të paafatshme.

Siç u përmend edhe në metodologji, kjo pjesë shtjellon të gjitha pretendimet të cilat KMSHK i ka pranuar gjatë vitit 2025 dhe të gjitha vendimet, të cilat ky trup vetërregullues i mediave të shkruara dhe online i ka marrë lidhur me pretendimet në fjalë.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në vitin 2025 i ka mbajtur 11 mbledhje të kuvendit.

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka pranuar dhe ka shqyrtuar gjithsej 150 ankesa. (Ankesat dhe pretendimet e detajuara mund t'i gjeni në Aneksin 2).

Ankesat kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të:

- Kapitullit II (Raportimi i së vërtetës)
- Kapitullit III (Nxitja dhe gjuha e urrejtjes)
- Kapitullit IV (E drejta për t'u përgjigjur)
- Kapitullit V (Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale)
- Kapitullit VI (Trajtimi i tragjedi personale, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve)
- Kapitullit VII (Privatësia dhe mbrojtja e burimeve) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Sekretariati i KMSHK-së në raste të nevojshme ndërmjetëson me mediat në mënyrë që të gjendet një marrëveshje, duke mos pasur nevojë që të dërgohet ankesë.

Në grafikat në vijim mund t'i shihni të gjitha **vendimet e miratuara për vitin 2025, sipas muajve.**

Numri i ankesave dhe vendimet për janar - 11 ankesa



Grafika 4. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt - 12 ankesa



Grafika 5. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për mars - 6 ankesa



Grafika 6. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për prill - 7 ankesa



Grafika 7. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për maj - 18 ankesa



Grafika 8. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për qershor - 18 ankesa



Grafika 9. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për korrik - 18 ankesa



Grafika 10. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për gusht - 9 ankesa



Grafika 11. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për shtator - 7 ankesa



Grafika 12. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për tetor - 21 ankesa



Grafika 13. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për nëntor - 13 ankesa



Grafika 14. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Numri i ankesave dhe vendimet për dhjetor - 10 ankesa



Grafika 15. Numri i ankesave dhe vendimet për shkurt 2025

Pretendimet e palëve, të cilat ankohen në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, zakonisht janë për më shumë se një kapitull të kodit të etikës, të cilët mund të jenë shkelur nga mediat. Gjatë vitit 2025 ka pasur gjithsej **268 pretendime për shkelje**, nga të cilat janë evidentuar **102 shkelje** të kodit të etikës.

Më së shumti pretendime ka pasur për shkeljet e kapitujve II (Raportimi i së vërtetës), IV (E drejta për t'u përgjigjur) dhe VII (Privatësia dhe mbrojtja e burimeve).

Në vijim është paraqitur numri i përgjithshëm i **pretendimeve për shkelje** dhe numri i **shkeljeve** të kodit të etikës.

Numri i përgjithshëm i pretendimeve për shkelje dhe numri i shkeljeve të kodit të etikës



Grafika 16. Numri i përgjithshëm i pretendimeve për shkelje dhe numri i shkeljeve të kodit të etikës

Këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i **pretendimeve për shkelje** të kodit të etikës sipas kapitujve.

Numri i përgjithshëm i pretendimeve për shkeljen e kodit të etikës sipas kapitujve

Kapitulli I / Dispozitat e përgjithshme	0
Kapitulli II / Raportimi i së vërtetës	125
Kapitulli III / Nxitja dhe gjuha e urrejtjes	10
Kapitulli IV / E drejta për t'u përgjigjur	77
Kapitulli V / Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar	8
Kapitulli VI / Trajtimi i tragjediave personale, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve	3
Kapitulli VII / Privatësia dhe mbrojtja e burimeve	45
Kapitulli VIII / Trajtimi i sinjalizuesve	0
Kapitulli IX / Korrupsioni dhe ryshfeti	0
Kapitulli X / Konflikti i interesit	0
Kapitulli XI / Të drejtat e autorit	0
Kapitulli XII / Reklamat dhe sponsorizimi	0
Gjithsej:	268

Grafika 17. Pretendimet për shkeljen e kodit të etikës sipas kapitujve

Ndërkaq, këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i **shkeljeve** të kodit të etikës sipas kapitujve.


Numri i përgjithshëm i shkeljeve të kodit të etikës sipas kapitujve

Kapitulli I / Dispozitat e përgjithshme	0
Kapitulli II / Raportimi i së vërtetës	41
Kapitulli III / Nxitja dhe gjuha e urrejtjes	1
Kapitulli IV / E drejta për t'u përgjigjur	40
Kapitulli V / Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar	2
Kapitulli VI / Trajtimi i tragjediave personale, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve	1
Kapitulli VII / Privatësia dhe mbrojtja e burimeve	17
Kapitulli VIII / Trajtimi i sinjalizuesve	0
Kapitulli IX / Korrupsioni dhe ryshfeti	0
Kapitulli X / Konflikti i interesit	0
Kapitulli XI / Të drejtat e autorit	0
Kapitulli XII / Reklamat dhe sponsorizimi	0
Gjithsej:	102

Grafika 18. Shkeljet e kodit të etikës sipas kapitujve

Këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i **pretendimeve për shkelje** të kodit të etikës sipas muajve.


Numri i përgjithshëm i pretendimeve për shkeljen e kodit të etikës sipas muajve



Grafika 19. Pretendimet për shkeljen e kodit të etikës sipas muajve

Ndërsa këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i **shkeljeve** të kodit të etikës sipas muajve.

Numri i përgjithshëm i shkeljeve të kodit të etikës sipas muajve



Grafika 20. Shkeljet e kodit të etikës sipas muajve

Përfundime

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), si trup vetërregullues i mediave të shkruara dhe online në Kosovë, synon që pjesë të veten të bëjë sa më shumë media. Në këtë mënyrë, ato obligohen të respektojnë kodin e etikës dhe, po ashtu, të kontribuojnë për një gazetari etike dhe të përgjegjshme.

Trendi i ankesave dhe pretendimeve të ngritura nga palët gjatë periudhës së raportimit është rritur.

Sipas të dhënave të përfshira në këtë raport, KMSHK ka pranuar më së shumti ankesa me pretendimin se janë shkelur kapitujt që kanë të bëjnë me raportimin e së vërtetës dhe të drejtën për t'u përgjigjur, por vërehet edhe shtimi i numrit të ankesave që kanë të bëjnë me raportimin rreth privatësisë, përkatësisht personave të përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale.

Gjatë kësaj periudhe më shumë se **43 për qind** e ankesave janë **miratuar plotësisht ose pjesërisht**, janë **refuzuar 38 për qind** e ankesave, një numër ankesash janë orientuar në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), pasi që kanë pasur të bëjnë me shkelje e pretenduara në televizione, ndërsa disa ankesa janë shpallur të patrajtueshme, sepse kanë pasur të bëjnë me rrjetet sociale, të cilat nuk janë në përgjegjësinë e KMSHK-së.

KMSHK do të vazhdojë t'i inkurajojë të gjithë konsumuesit e përmbajtjeve mediale në mediat e shkruara dhe online që, për të gjitha pretendimet për shkelje etike, t'i drejtohen këtij trupi vetërregullues.

Po ashtu, do të vazhdojë të punojë ngushtë me media, me akterë relevantë në fushën e gazetarisë dhe partnerë nga sektori joqeveritar, akademik dhe institucionet, për edukimin medial dhe respektimin e etikës gjatë raportimit.

Aneksi 1 – Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës

Preambula

Ky kod, i cili mbështetet në standardet ekzistuese ndërkombëtare të praktikës sëgazetarisë, shërben si bazë për sistemin vetërregullues i cili do të konsiderohet profesionalisht dhe moralisht i obligueshëm për gazetarë, reporterë, redaktorë, pronarë dhe botues të gazetave, mediave online (portaleve të lajmeve) dhe agjencive të lajmeve (tutje mediat e shkruara). Gazetarët dhe redaktorët do të respektojnë parimet etike në vijim dhe do të mbrojnë integritetin profesional të gazetarisë. Redaktorët dhe botuesit do të sigurojnë që i gjithë stafi të jetë i informuar për këtë kod. Për më tepër, ata do të sigurojnë respektimin e të gjitha dispozitave të këtij kodi. Këto rregulla vlejnë edhe për video storiet e prodhuara/publikuara në mediat e shkruara.

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Është detyrë e gazetarëve dhe e redaktorëve të respektojnë të drejtën e qytetarëve për informim me kohë dhe në plotëni. Gazetarët dhe redaktorët do të mbrojnë parimet e lirisë së informimit, të drejtën e komentimit të duhur dhe të gazetarisë kritike.
2. Mediat e shkruara do të respektojnë standardet ndërkombëtare të mirësjelljes dhe të diversitetit etnik, kombëtar, racor, gjinor, seksual, kulturor e fetar.
3. Gazetarët dhe redaktorët nuk do të inkurajojnë, qëllimisht apo tërthorazi, diskriminimin dhe jotolerancën. Po ashtu, i gjithë informacioni nga ta duhet të mblidhet në mënyrë etike.
4. Gazetarët nuk do të veprojnë si përfaqësues të opinionit publik. Mediat nuk mund t'i zëvendësojnë funksionet specifike të autoriteteve apo institucioneve publike.
5. Gazetarët duhet të zbatojnë me kujdes rregullat e gjuhës në të cilën ata shkruajnë.
6. Vëzhgimi kritik i implementimit të pushtetit politik dhe ekonomik do të jetë ndër obligimet qenësore të mediave të shkruara.
7. Mediat do të tregojnë transparencë në çështjet e pronësisë dhe të menaxhimit, duke u mundësuar kështu qytetarëve të dinë se kush janë pronarët dhe cili është interesi i tyre ekonomik në media.

II. Raportimi i së vërtetës

1. Gjatë punës së tyre gazetarët dhe redaktorët duhet ta respektojnë të vërtetën faktike dhe të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën.
2. Gazetarët dhe redaktorët, në parim, duhet të mbështeten në burime të identifikueshme të informacioneve.
3. Duhet të bëhet dallimi i qartë ndërmjet lajmeve dhe opinionëve. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionin bart mendime, ide, besime apo gjykime vlerësuese nga ana e botuesve, gazetarëve dhe redaktorëve.
4. Liria e shtypit përjashton shpifjen dhe fyerjen, nxitjen e urrejtjes apo dhunës në bazë të racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paafësisë, sëmundjes, moshës, etnisë apo kombësisë. Gazetarët dhe redaktorët kanë obligim që të ndalojnë promovimin e shpifjes dhe fyerjes apo nxitjes së urrejtjes dhe dhunës së çfarëdo forme. Ndalimi vlen edhe për opinionet dhe komentet brenda shkrimeve.
5. Gazetarët dhe redaktorët kanë obligim profesional që me kohë të korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar, për të cilin vërtetohet se është i pasaktë.
6. Ndalohet që fotografitë, imazhet, audiot apo videot dhe dokumentet të falsifikohen dhe/apo të shfrytëzohen për qëllime keqinformimi.
7. Ndalohet për çdo gazetar dhe media të shkruar që të bëjë plagjiaturë. Gjithmonë duhet të theksohet burimi i informacionit që është publikuar diku tjetër.

8. Media nuk duhet të shtrembërojë apo keqpërdor deklaratat e bëra në kontekste të caktuara.
9. Mediat duhet të krijojnë praktika të qarta të identifikimit të burimeve dhe verifikimit të fakteve para publikimit të lajmit, me fokus të veçantë në identifikimin e burimit të parë të informacionit.
10. Mediat duhet të angazhohen në verifikimin e fakteve qoftë brenda redaksive, qoftë duke bashkëpunuar me individë ose organizata që merren me verifikimin e fakteve.

II.1. Lajmet e rreme (Fake News)

1. Mediat e shkruara duhet të verifikojnë informacionin përpara botimit, ashtu që të sigurohet se informacioni është i vërtetë, i bazuar në fakte dhe i besueshëm.
2. Nëse mediat e shkruara kanë informacion të pakonfirmuar dhe atë e paraqesin në publik, atëherë duhet të bëhet e qartë për publikun se informacioni i tillë nuk është i konfirmuar. Inkurajohet që informacioni i tillë të mos botohet deri në verifikim.
3. Mediat e shkruara nuk duhet të përdorin apo botojnë, shfaqin apo publikojnë në çfarëdo forme, tekste, audio, video apo dokumente të manipuluar.
4. Mediat duhet të kenë kujdes në verifikimin e të gjitha llojeve të lameve të rreme, të shfaqura në formën Deepfake ose forma të tjera të ngjashme të avancuara, të krijuara me ndihmën e inteligjencës artificiale.

II.2. Inteligjenca artificiale (AI)

1. Mediat mund të përdorin inteligjencën artificiale në procesin e krijimit të përmbajtjes mediale, por në mënyrë të përgjegjshme dhe proporcionale. Kur përdorin inteligjencën artificiale, mediat duhet të respektojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sigurisë së informacionit dhe mosdiskriminimit.
2. Përmbajtja mediatike e krijuar me ndihmën e inteligjencës artificiale bie në përgjegjësinë editoriale të medias dhe nuk i liron gazetarët dhe redaktorët nga përgjegjësia për të respektuar asnjë rregull të parashikuar nga ky kod.
3. Mediat janë të obliguara t'i informojnë lexuesit në mënyrë të përshtatshme për përdorimin e inteligjencës artificiale në krijimin e përmbajtjes mediale, me shënim se në cilin segment dhe çfarë lloji i inteligjencës artificiale është përdorur dhe si funksionon.
4. Gjatë përdorimit të inteligjencës artificiale mediat duhet të respektojnë të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale. Nëse lexuesit mund të kenë ndërveprime me inteligjencën artificiale, ata duhet të informohen paraprakisht se këto ndërveprime nuk po bëhen me njerëzit.
5. Në lidhje me vendimet e marra nga inteligjenca artificiale, të cilat mund të shqetësojnë lexuesit, atyre duhet t'iu sigurohet komunikimi me një person fizik dhe mundësia për të kundërshtuar vendimin përkatës.

III. Nxitja dhe gjuha e urrejtjes

1. Mediat e shkruara në asnjë rrethanë nuk do të nxisin dhe promovojnë nëpërmjet shkrimeve, fotografive, videove apo imazheve tjera të montuara veprime kriminale apo të dhunshme.
2. Mediat e shkruara do të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi, në shkrime, opinione apo komente, duke:
a. Trajtuar me paragjykim një individ apo grup mbi baza të përkatësisë etnike, kombëtare, fetare, gjinore, racore, martesore, të orientimit seksual, sëmundjes, të moshës apo paaftësisë fizike e mendore;
b. Përdorur shprehje denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, kombëtare, fetare, gjinore, racore, martesore, të orientimit seksual, sëmundjes, të moshës apo paaftësisë fizike e mendore.
3. Referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të përmenden vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen, për të cilën raportohet.

IV. E drejta për t'u përgjigjur

1. Është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve dhe agjencive të lajmeve të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë.
2. E drejta për t'u përgjigjur do t'u mundësohet personave përkatës nëse botimi në fjalë përcakton që duhet të ndërmerret një hap i tillë për qëllime të korrektësisë dhe paanshmërisë. Duhet të ekzistojë mundësia për publikim të menjëhershëm të reagimit/përgjigjes në mediumin në fjalë.
3. Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kundërthënëse, çdoherë mediat e shkruara duhet t'i dëgjojnë dhe t'i përfaqësojnë të gjitha palët e përfshira. Gazetari, redaktori dhe media duhet të ndërmarrin çdo veprim të mundshëm për të kontaktuar palët, përfshirë por duke mos u kufizuar në telefonata, mesazhe telefonike, mesazhe në rrjetet sociale, email, letër nëpërmjet postës, kërkesë për takim.
4. Nëse njëra palë refuzon t'i përgjigjet gazetarit, publikimi do të duhej ta theksojë këtë refuzim gjatë raportimit, si dhe përpjekjet që media dhe gazetari ka ndërmarr për ta siguruar përgjigjen e tij/saj.
5. Media e shkruar duhet ta njoftojë personin që po intervistohet se cila media është dhe në çfarë konteksti do të përdoret deklarimi i tij/saj.

V. Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale

1. Mediat e shkruara nuk do ta trajtojnë asnjë individ si fajtor, para se diçka e tillë të konfirmohet nga gjykata. Mediat e shkruara gjatë raportimit për incidente, aksidente apo vepra penale duhet të kenë parasysh prezuminin e pafajësisë për secilin të përfshirë dhe si të tillë duhet ta paraqesin në shkrim/raportim.
2. Gazetarët dhe redaktorët janë të obliguar të mos paragjykojnë fajësinë e një personi të akuzuar.
3. Gazetarët dhe redaktorët obligohet që të respektojnë urdhrin e gjykatës për mospublikim të informatave bazë të të akuzuarve. Raportimi nga gjykata duhet të bëhet në respektim të plotë të pikave të mësipërme.

VI. Trajtimi i tragjediave personale, mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve

1. Gazetarët nuk do t'i intervistojnë apo fotografojnë fëmijët nën moshën 18-vjeçare rreth çështjeve që kanë të bëjnë me familjen e tyre, me ta apo me persona të afërt të tyre, pa pëlqimin e prindit apo të ndonjë të rrituri, i cili është përgjegjës për fëmijën.
2. Mediat e shkruara asnjëherë nuk duhet t'i publikojnë emrin, atësinë/amësinë dhe mbiemrin, fotografi, video apo imazhe të tjerë të fëmijëve nën moshën 18 vjeçare, të cilët janë të përfshirë apo ndërlidhur me/në aksidente, incidente, dhunë, vepra penale, fatkeqësi natyrore apo veprime të tjera.
3. Në rastet kur mediat publikojnë fotografi, video apo imazhe të tjera të fëmijëve apo të personave të tjerë, por ku shfaqen fëmijët, atëherë obligohen që t'i mbulojnë fytyrat, shenjat dalluese të fëmijës, apo rrethanat tjera që mund ta identifikojnë fëmijën (psh: shtëpia ku banon, shkolla ku vijon mësimin, lagjja ku banon etj).
4. Mediat e shkruara në asnjë mënyrë nuk do të identifikojnë fëmijët nën moshën 18-vjeçare, të cilët janë të përfshirë në vepra penale, qoftë si dëshmitarë apo të pandehur.
5. Trajtimi i rrëfimeve të tragjeditë personale duhet të zhvillohet me kujdes dhe vetëm kur ka interes të lartë publik mbi çështjen. Nëse interesi publik është i lartë, atëherë ndaj fëmijëve të prekur nga tragjedia duhet pasur qasje mirëkuptimi, mbrojtje të privatësisë, mbulim të fytyrës, dhe diskrecion.
6. Mediat duhet të respektojnë të drejtën e njerëzve për të mbajtur zi dhe duhet të raportojnë duke treguar empati dhe vetëpërmbytje. Mediat duhet të respektojnë vuajtjet e viktimave dhe ndjenjat e familjarëve të tyre. Po ashtu, mediat duhet të tregojnë maturi me fotografitë dhe pamjet, si dhe duhet të kenë në konsideratë ndjeshmërinë e publikut gjatë raportimit.

VII. Privatësia dhe mbrojtja e burimeve

1. Mediat e shkruara do t'u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përveç në rastet kur ndërhyrjet apo kërkimet e tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik.
2. Gazetarët, redaktorët dhe mediat e shkruara duhet të respektojnë dinjitetin e viktimave dhe familjeve të tyre duke mos i paraqitur në media fotografitë, videot apo incizimet tjera të të aksidentuarve, të të dhunuarve, të të vrarëve, të të vetëvlarëve apo personave të lidhur me ta, e në veçanti fëmijëve që janë pjesë e aksidentit, incidentit, fatkeqësisë natyrore apo veprës penale. Mediat e shkruara edhe gjatë raportimit duhet të lejojnë njerëzit të mbajnë zi privatisht, duke i trajtuar me shumë kujdes ngjarjet e tilla.
3. Mediat e shkruara nuk duhet që fotografitë ose videot nga vendi i ngjarjes t'i publikojnë pa mbuluar identitetin apo trupin e viktimave pas aksidentit, incidentit, dhunës, fatkeqësisë natyrore apo veprës penale. Publikimi i fotografive ose videove të tilla do të konsiderohet fyerje për ndjenjat e familjarëve të viktimave dhe të ndjeshme për publikun.
4. Mediat e shkruara nuk duhet të publikojnë lajme me fotografi apo video ku paraqiten viktimat apo personat e zhdukur dhe të njëjtit në raportim të identifikohen me emër dhe mbiemër. Përgjashtim nga publikimi i emrit e mbiemrit janë rastet kur për viktimat apo personat e zhdukur ka interes publik.
5. Mediat e shkruara janë të obliguara të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse këtë paraprakisht e kërkojnë apo jo.

VIII. Trajtimi i sinjalizuesve

1. Mediat e shkruara duhet të kujdesen veçanërisht në secilin rast të sinjalizimit, ashtu që sinjalizuesi duhet të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe t'i jepet mundësi e barabartë me personat e tjerë të përfshirë në artikull.
2. Mediat e shkruara bëjnë shkelje të rëndë të këtij kodi në momentin që fillon fushata linçuese apo fushata të degradimit për dhe kundër sinjalizuesit apo personave të lidhur me të.
3. Mediat e shkruara duhet të kujdesen që në secilin rast të sinjalizimit, personat kundër të cilëve është duke u sinjalizuar duhet të trajtohen si të pafajshëm deri në vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

IX. Korrupsioni dhe ryshfeti

1. Gazetarët nuk do të pranojnë poste, ryshfet apo cytje të tjera të cilat shkaktojnë konflikt interesi me profesionin e tyre dhe të cilat komprometojnë kredibilitetin e tyre moral dhe profesional.
2. Gazetarët, redaktorët dhe mediat e shkruara nuk do të pranojnë veprime të caktuara zemërgjerësie, të cilat ndikojnë në pavarësinë e tyre profesionale.

X. Konflikti i interesit

1. Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën gazetari, redaktori apo media në tërësi ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës.
2. Gjatë gjithë punës media, redaktorët dhe gazetarët kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë, në mënyrën më efektive të mundshme çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tyre publike dhe private.

XI. Të drejtat e autorit

1. Gazetarët dhe mediat e shkruara duhet ta respektojnë të drejtën e autorit në çdo fushë për të cilën ata raportojnë (shkrimet, hulumtimet, raportimet, lajmet, fotografitë, imazhet, videot, përkthimet etj). Plagjiatura është e ndaluar dhe konsiderohet shkelje e kodit.
2. Mediat e shkruara apo gazetarët në rast se marrin citate nga shkrimi i një medie tjetër duhet ta citojnë saktë dhe ta përshkruajnë ashtu siç është thënë në median bazë, pa e shtrembëruar atë.
3. Publikimet mund të përdoren arsyeshëm, me citate të kufizuara materiale nga publikimet tjera apo nga pronarë të së drejtës së autorit, pa leje të shprehur të tyre për ta bërë një gjë të tillë, pasi të ketë kaluar së paku 6 orë nga botimi i materialit. Megjithatë, botimi i gjithë materialit në fjalë do të mund të realizohet vetëm pas lejes paraprake të mbajtësit të së drejtës së autorit.
4. Përkthimi dhe përshtatja e materialeve nga mediat botërore dhe më pas publikimi i tyre në median e shkruar po ashtu do të konsiderohet e drejtë e autorit dhe duhet të respektohet sikur pikat më sipër.

XII. Reklammat dhe sponzorizimi

1. Reklamimi komercial e politik, si dhe materiali sponzorizues - përfshirë këtu edhe artikuj e shtojca - duhet të dallohen qartë nga përmbajtja editoriale dhe të identifikohen si të tilla.
2. Në materialin e sponzorizuar duhet të tregohet qartë burimi i sponzorizimit.

Aneksi 2 – Ankesat e pranuar dhe të trajtuara gjatë vitit 2025

1. Leutrim Sahiti kundër Indeksonline.net, refuzuar
2. Ekrem Lluka, përfaqësuar nga avokatja Vjosa Shkodra, kundër Veriu.info, refuzuar
3. Iljasa Fazliu, përfaqësuar nga avokati Emin Zariqi, kundër Nacionale.com, miratuar pjesërisht
4. Isuf Zejna kundër Demokracia.com, miratuar
5. Isuf Zejna kundër Paparaci.com, miratuar
6. Isuf Zejna kundër Periskopi.com, miratuar
7. Arian Hashani kundër Gazetademos.com, miratuar
8. Arben Krasniqi kundër Prishtinapress.org, miratuar
9. Shqipron Krasniqi kundër Prishtinapress.org, miratuar
10. Fitore Pacolli, përfaqësuar nga avokatja Lendita Keqekolla, kundër Nacionale.com, e paafatshme
11. Avicena ShPK, përfaqësuar nga avokati Arianit Koci, kundër Sinjali.com, e paafatshme
12. Valicon D.O.O. kundër Demokracia.com, Nacionale.com, Sinjali.com, Paparaci.com dhe Gazetademos.com, miratuar pjesërisht
13. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kundër Periskopi.com, miratuar pjesërisht
14. A.L. Dushi ShPK, përfaqësuar nga kompania e avokaturës RPHS, kundër Gazetaexpress.com, miratuar
15. Fisnik Korenica kundër Paparaci.com, Nacionale.com, Periskopi.com dhe Veriu.info, miratuar pjesërisht
16. Arjeta Krasniqi kundër Indeksonline.net, Kosovapress.com, Telegrafi.com, Klankosova.tv, Atvlive.tv, Demokracia.com, Lajmi.net dhe Telenews.al, refuzuar
17. Samedin Abazi, përfaqësuar nga avokati Arbër Jashari, kundër Paparaci.com, miratuar
18. Telekom i Kosovës kundër Demokracia.com, Fokusi.info dhe Indeksonline.net, miratuar pjesërisht
19. Lëvizja Vetëvendosje kundër Berat Buzhalës, e patrajtueshme
20. Lëvizja Vetëvendosje kundër Berat Buzhalës, e patrajtueshme
21. Xhafer Tahiri kundër Gazetainfokus.com, miratuar pjesërisht
22. Xhafer Tahiri kundër Jepize.com, miratuar pjesërisht
23. Shkelzen Deçani kundër Sinjali.com, miratuar
24. Instituti Sekhmet kundër Sinjali.com, miratuar
25. Rilind Gërvalla kundër Nacionale.com, refuzuar
26. Pro ACC Group, përfaqësuar nga Alliance Legal Group, kundër Demokracia.com, e paafatshme
27. Taulant Maliqi kundër Insajderi.org dhe Radiostargjilan.com, refuzuar
28. Arber Gashi kundër Indeksonline.net, miratuar
29. Zana Haxhaj kundër Indeksonline.net, miratuar
30. Shpend Haxhibeqiri, përfaqësuar nga avokat Florim Shefqeti, kundër Nacionale.com, refuzuar
31. Shqipe Muja kundër Indeksonline.net, Istogu Sot, Al Press dhe Kanal 10, miratuar pjesërisht
32. Radio Televizioni i Kosovës kundër Reporteri.net, refuzuar
33. Posta dhe Telekom i Kosovës kundër Indeksonline.net, miratuar
34. Posta dhe Telekom i Kosovës kundër Indeksonline.net, miratuar
35. Bleona Kurteshi kundër Paparaci.com, miratuar
36. Driton Kastrati kundër Arbresh.info, refuzuar
37. Ardian Emmini kundër Kallxo.com, refuzuar
38. Posta dhe Telekom i Kosovës kundër Demokracia.com, refuzuar
39. Bujar Guci, përfaqësuar nga Inlex Law Firm kundër Sinjali.com, miratuar
40. Elvina Dushaj-Osmeni kundër Sinjali.com, miratuar
41. Lekë Nikollbibaj kundër Sinjali.com, Klankosova.tv, Gazetaprishtina.info dhe Kosovapost.net, miratuar pjesërisht
42. Blerina Hoxha-Gjuraj kundër Nacionale.com, e paafatshme
43. Blerina Hoxha-Gjuraj kundër Nacionale.com, e patrajtueshme
44. Enver Krasniqi, përfaqësuar nga avokati Jeton Idrizi kundër Paparaci.com, miratuar
45. Jeton Ukësmajli kundër Botasot.info, Arbresh.info, Koha.net, Albanianpost.com, Insajderi.org, Paparaci.com, Zëri.info, Demokracia.com dhe Kosova.info, e paafatshme
46. Posta dhe Telekom i Kosovës kundër Insajderi.org, refuzuar
47. Isak Kukaj kundër Sinjali.com, e paafatshme
48. KOSOVAMED Healthcare Sh.P.K. kundër Insajderi.org, refuzuar
49. Naim Mehmeti, përfaqësuar nga avokati Granit Hadërgjonaj kundër Indeksonline.net, e patrajtueshme
50. Xhenet Syka Kelmendi, përfaqësuar nga avokatja Erina Berisha kundër Pejanefokus.net, miratuar pjesërisht
51. Nuray Çürt Aşikferki kundër Klan Kosova, e patrajtueshme
52. Resa Krasniqi kundër Indeksonline.net, miratuar
53. Shkelqim Millaku kundër Klankosova.tv, refuzuar
54. Duda Balje, përfaqësuar nga avokatja Nora Huseinovic kundër Kosova.info, e patrajtueshme
55. Dren Paca kundër Insajderi.org, miratuar pjesërisht
56. Emin Raci kundër Periskopi.com, miratuar
57. OJQ Aktiv kundër Kosovapress.com, Telegrafi.com, Botasot.info, Njeshi.com dhe Diasporashqiptare.al, miratuar pjesërisht
58. Delfin LTD, përfaqësuar nga avokati Labinot Murati, kundër Veriu.info, refuzuar
59. Delfin LTD, përfaqësuar nga avokati Labinot Murati, kundër Insajderi.org, refuzuar
60. Shpëtim Dobra kundër Insajderi.org, refuzuar
61. Arta Müller kundër Sinjali.com, miratuar
62. Caritas Kosova kundër Veriu.info, miratuar pjesërisht
63. Delfin LTD, përfaqësuar nga avokati Labinot Murati, kundër Periskopi.com, refuzuar
64. Arban Abrashi kundër Insajderi.org, e paafatshme
65. Flutura Berbat-Zena kundër Insajderi.org, miratuar pjesërisht
66. Mefail Kryeziu kundër Sinjali.com, refuzuar
67. Lendrit Iljazi kundër Klankosova.tv, refuzuar
68. Arban Abrashi kundër Insajderi.org, refuzuar
69. Afërdita Dreshaj, përfaqësuar nga avokati Virtyt Ibrahimaga kundër Privebruto.com, miratuar pjesërisht
70. Halim Rexhepi kundër Klankosova.tv, miratuar pjesërisht
71. Produkte Bio kundër Kallxo.com, refuzuar
72. Ardit Kololli kundër N'Teren (faqe në Facebook), e patrajtueshme
73. Meka Sh.P.K. përfaqësuar nga avokati Sylejman Klinaku kundër Veriu.info, refuzuar
74. Mirsad Dakaj kundër Kosova.info, miratuar pjesërisht

75. Leonora Gashi kundër Kallxo.com, e patrajtueshme
76. Rigon Osmani kundër Sinjali.com, miratuar
77. Shkelzen Haliti kundër Jepize.com, miratuar
78. Kristian Kabashi kundër Insajderi.org dhe Reporteri.net, refuzuar
79. Viola Azemi kundër Indeksonline.net, refuzuar
80. Viola Azemi kundër Indeksonline.net, Arbresh.info dhe Botasot.info, refuzuar
81. Meditech Sh.P.K. përfaqësuar nga shoqëria e avokatëve RPHS Law, kundër Frontonline.net, miratuar pjesërisht
82. Berat Ganiqi kundër Telegramisot.info, miratuar pjesërisht
83. Universiteti "Fehmi Agani", Gjakovë kundër Insajderi.org, refuzuar
84. Berto Sh.P.K. kundër Insajderi.org, refuzuar
85. Berto Sh.P.K. kundër Veriu.info, refuzuar
86. Berto Sh.P.K. kundër Jepize.com, refuzuar
87. Zize Pajaziti, përfaqësuar nga avokati Shkelzen Behrami, kundër Insajderi.org, refuzuar
88. Rilind Gërvalla kundër Nacionale.com, miratuar
89. Albiona Tasholli kundër Edona Gashit, e patrajtueshme
90. Alban Blakaj kundër Klankosova.tv, miratuar
91. Alban Blakaj kundër Klankosova.tv, miratuar
92. Alban Blakaj kundër Klankosova.tv, miratuar
93. Alban Blakaj kundër Klankosova.tv, miratuar
94. Ardonis Halimi kundër O6 News dhe Lajmi.net, refuzuar
95. Suela Rabushaj kundër Sinjali.com, refuzuar
96. Luisa Rabushaj kundër Sinjali.com, refuzuar
97. Zenel Sellaj kundër Sinjali.com, miratuar
98. Daniel Thomas Loitz kundër Fitim Çekut, e patrajtueshme
99. Pirro Piraj kundër Veriu.info, Gazetabolic.com dhe Insajderi.org, refuzuar
100. Zize Pajaziti, përfaqësuar nga avokati Shkelzen Behrami, kundër TV Klan Kosova, e patrajtueshme
101. Rilind Gërvalla kundër Nacionale.com, refuzuar
102. Vlora Bajrami kundër Kallxo.com, refuzuar
103. Albinot Bimbashi kundër Kosovalive.net, miratuar pjesërisht
104. Telekom i Kosovë Sh.A. kundër Shenjester.net, miratuar pjesërisht
105. Zize Pajaziti, përfaqësuar nga avokati Shkelzen Behrami, kundër Gazetaexpress.com, e paafatshme
106. Arsim Halili kundër Kallxo.com, miratuar
107. Arsim Halili kundër Kallxo.com, refuzuar
108. Fondi për Sigurim Shëndetësor kundër Voxkosova.com, refuzuar
109. Arsim Halili kundër Kallxo.com, miratuar pjesërisht
110. Mirjeta Xhemalji kundër Sinjali.com, refuzuar
111. Driton Bardheci, përfaqësuar nga avokati Granit Hadërgjonaj, kundër Klina Info, e patrajtueshme
112. Seat Rexhepagiq kundër Kosovapress.com, Rtv21.tv, Dtvmedia.tv, Veriu.info, Kosova.info, refuzuar
113. Jeta Xharra kundër Voxkosova.com, refuzuar
114. Nuhi Neziri kundër Klankosova.tv, miratuar
115. Lejla Qollaku kundër Prishtina-post.com, e patrajtueshme
116. OJQ Aktiv kundër Gazetaexpress.com, Kosova.info, Radiokosovaelire.com dhe Faktiditor.ch, miratuar pjesërisht
117. OJQ Aktiv kundër TV Klan Kosova dhe Klankosova.tv, miratuar pjesërisht
118. Kastriot Paluca kundër Sinjali.com, miratuar pjesërisht
119. Selajdin Beqa, përfaqësuar nga shoqëria e avokatëve LLC, kundër Voxkosova.com, refuzuar
120. Shpresa Gagica-Selmani përfaqësuar nga Taulant Selmani, kundër Klankosova.tv, miratuar
121. Shpend Haxhibeqiri, përfaqësuar nga avokat Visar Vehapi, kundër Nacionale.com, refuzuar
122. Arif Spahiu, përfaqësuar nga avokati Arbër Jupolli, kundër Insajderi.org, miratuar
123. Arif Spahiu, përfaqësuar nga avokati Arbër Jupolli, kundër Sinjali.com, miratuar
124. Arif Spahiu, përfaqësuar nga avokati Arbër Jupolli, kundër Botasot.info, miratuar
125. Arif Spahiu, përfaqësuar nga avokati Arbër Jupolli, kundër Shekulli.info, e patrajtueshme
126. Arif Spahiu, përfaqësuar nga avokati Arbër Jupolli, kundër Llapi.info, miratuar
127. Nevruz Hasani kundër Insajderi.org, refuzuar
128. Termokos Sh.A. kundër Gazetakosova.net, miratuar pjesërisht
129. Betim Lushtaku, përfaqësuar nga avokati Agon Rrecaj, kundër Prishtina Sot, e patrajtueshme
130. Blinera Osmani kundër Nacionale.com, Reporteri.net dhe Periskopi.com, refuzuar
131. Bergita Curri kundër Insajderi.org, e patrajtueshme
132. Rilind Gërvalla kundër Reporteri.net, refuzuar
133. Mehdi Sejdiu kundër Paparaci.com, miratuar
134. Blendina Hoxha kundër Klankosova.tv, refuzuar
135. Lëvizja Vetëvendosje kundër Paparaci.com, refuzuar
136. Lëvizja Vetëvendosje kundër Nacionale.com, refuzuar
137. Lëvizja Vetëvendosje kundër Periskopi.com, refuzuar
138. Lëvizja Vetëvendosje kundër Jepize.com, refuzuar
139. Lëvizja Vetëvendosje kundër Reporteri.net, refuzuar
140. Edison Tahiraj kundër Sinjali.com, e paafatshme
141. Ilir Kiqmari kundër Gazetademos.com, e patrajtueshme
142. Medi Premium Sh.P.K. përfaqësuar nga Albert Halilaj, kundër Veriu.info, miratuar pjesërisht
143. Ganimete Musliu kundër Rajoni.org, refuzuar
144. Bastri Ademi kundër Indeksonline.net, e patrajtueshme
145. Marigona Kastrati, përfaqësuar nga avokati Taulant Ferizi, kundër KlanKosova.tv dhe Demokracia.com, miratuar pjesërisht
146. KEDS, përfaqësuar nga Dërguti Law Firm, kundër Buletiniekonomik.com, refuzuar
147. Ukë Zenuni kundër Ulpianapress.net, miratuar
148. Valon Krasniqi kundër Sinjali.com, refuzuar
149. Telekom i Kosovës kundër Klankosova.tv, refuzuar
150. Aurora Mulhaxha kundër Sinjali.com dhe Ballkani.info, e patrajtueshme



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

ETIKOS

Etika e raportimit
në media online
2025

